



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/

Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,

Technology and Innovation

Kabineti i Ministres / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 27.01.2026

Nr.: 01-716

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 24, 25 dhe 26 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nënparagrafit 1.5 të paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G. z. e Republikës së Kosovës nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë), si dhe dispozitave të Ligjit nr.02/L-67 për Botimin e Teksteve Shkollore, Mjeteve Mësimore, Lektyrës Shkollore dhe të Dokumentacionit Pedagogjik, nxjerr:

V E N D I M

Për rishikimin e kurrikulave lëndore/programeve mësimore për arsimin fillor 1-5 si dhe arsimin e mesëm të ulët 6-9

1. Inicohet rishikimi i kurrikulave lëndore/programeve mësimore për arsimin fillor 1-5 si dhe arsimin e mesëm të ulët 6-9, në përputhje me Kornizën kurrikulare, kurrikulat bërthamë dhe Strategjinë e Arsimit Parauniversitar 2022-2026.
2. Me qëllim të zbatimit të pikës 1 të këtij vendimi, themelohet grupi koordinues për udhëheqjen e procesit të rishikimit të kurrikulave lëndore/programeve mësimore, me përbërje nga zyrtarë të MASHTI-t, profesorë universitarë, mësimdhënës dhe ekspertë të arsimit.
3. Me vendim të veçantë përcaktohen:
 - 3.1 Anëtarët e grupit koordinues;
 - 3.2 Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të grupit koordinues;
 - 3.3 Kriteret e vlerësimit, mënyra e zhvillimit të punës dhe metodologjia;
 - 3.4 Raportimet e grupit koordinues.
4. Raporti final me gjetjet dhe rekomandimet lidhur me rishikimin e kurrikulave lëndore/programeve mësimore të dorëzohet te Ministrja jo më larg se 30 prill 2026.
5. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe nevojës për ngritjen e rezultateve të nxënësve, krahas masave tjera, është vlerësuar që nevojiten tekste cilësore dhe në përputhje me Kornizën kurrikulare, kurrikulat bërthamë, kurrikulat lëndore/programet mësimore dhe për këtë është vlerësuar që rishikimi i kurrikulave/programeve mësimore është thelbësor, për të siguruar rezultate të nxënësve dhe ofrimin e teksteve cilësore dhe burimeve tjera mësimore që mbështesin procesin e të mësuarit.

Prandaj, duke marrë parasysh ato që u cekën më lart, në pajtim me legjislacionin në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
2. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
3. DAP/MASHTI;
4. Arkivit të MASHTI.


Arbërie Nagavci
Ministre në detyrë/MASHTI